



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.1258, datë 16.04.2010

Për

**“Miratimin e menyres se shfrytezimit te spektrit BWA :
3400 – 3600 MHz, 3600 – 3800 MHz per sherbimin e aksesit pa tel me brez te gjere
BWA – Broadband Wireless Access”**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
3. Z. Benon	Paloka	Anëtar
4. Z. Ibsen	Elezi	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj.Marsida Drushku, në mbledhjen e dates 16.04. 2010, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

**“Miratimin e menyres se shfrytezimit te spektrit BWA :
3400 – 3600 MHz, 3600 – 3800 MHz per sherbimin e aksesit pa tel me brez te gjere
BWA – Broadband Wireless Access”.**

BAZA LIGJORE:

1. Pika 3) e Nenit 7, shkronja a) pika 3 e Nenit 62 te ligjit Nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (*Ligji nr. 9918*);
2. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendshme të AKEP (*Rregullorja e Brendshme*), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, Nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918;

K Ë SHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, si dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar:

V Ë R E N:

1. Dokumentacioni per “**Miratimin e menyres se shfrytezimit te spektrit BWA : 3400 – 3600 MHz, 3600 – 3800 MHz per sherbimin e aksesit pa tel me brez te gjere BWA – Broadband Wireless Access**”.

eshte pergatitur ne perputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator perkates.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Duke marrë në konsideratë:

- sigurimin e nje perdorimi efektiv te frekuencave te brezit BWA
- shmangien e interferencave
- rritjen e disponueshmerise

bazuar ne piken 3) te Nenit 7, shkronjen a) te pikes 3 te Nenit 62 , pikën 1 të nenit 114 dhe pikën 1 të nenit 115 të ligjit nr. 9918, si dhe Pika 17 e nenit 21 të Rregullores së Brendëshme,

V E N D O S:

1. Të miratojë “**Miratimin e menyres se shfrytezimit te spektrit BWA : 3400 – 3600 MHz, 3600 – 3800 MHz per sherbimin e aksesit pa tel me brez te gjere BWA – Broadband Wireless Access**” sipas Aneksit 1 bashkëlidhur
2. Akti i miratuar të publikohet në faqen e internetit www.akep.gov.al

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.


K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARET E KËSHILLIT DREJTUES:

1. **Alketa MUKAVELATI**
2. **Benon PALOKA**
3. **Ibsen ELEZI**
4. **Zamira NURCE**

Aneks 1



Autorizimi	Brezi i poshtem (MHz)	Brezi i siperm (MHz)	Gjeresia e brezit
A	3410 - 3452	3510 - 3552	2 x 42 MHz
B	3455.5 - 3497.5	3555.5 - 3597.5	2 x 42 MHz
C	3603.5 - 3645.5	3703.5 - 3745.5	2 x 42 MHz
D	3649 - 3691	3749 - 3791	2 x 42 MHz